



### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_715\_01\_12;

**Në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2012 nxori këtë:**

### **VENDIM**

**APROVOHET** ankesa e konsumatorit Steda Kosova (parashtruesi i ankesës Dashmirë Selmani) nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 28.03.2011 ka kundërshtuar faturën lidhur me ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

- Me datë 10.09.2009 KEK-u i ka lëshuar konsumatorit Shpk "Steda Kosova" (ish Hotel Unioni), Pëlqimin elektronergjetik të përkohshëm me fuqi instaluese prej 50 kVA, ku matja e energjisë elektrike duhet të bëhet me njehsor shumë-funksional (aktive, reaktive dhe maksigraf) dhe i lidhur përmes TMRR 75(100)/5 A/A.  
**Provë:** Pëlqimi elektronergjetik i përkohshëm i KEK-ut nr. 4674 i datës 10.09.2009
- Me datë 03.11.2009 bazuar në pëlqimin elektroenergjetik punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik me nr. 70172808 është shumë-funksional, por që energjia aktive regjistrohet në tri tarifa dhe si i tillë nuk mund të pranohet. Ekipi i KEK-ut përveç tjerash ka udhëzuar konsumatorin që në afat 3-5 ditë të bëjë ndërrimin e njehsorit elektrik në njehsor shumë-funksional e të licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës si dhe duhet të përmbahet pëlqimit elektroenergjetik, duke ndërruar TMRR nga 150/5A në 75/5A. Ekipi i KEK-ut po ashtu ka regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse përfshi gjendjen e njehsorit.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 183264 i datës 03.11.2009
- Me datë 18.03.2010 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për lidhje të re.  
**Provë:** Aplikacioni i KEK-ut për lidhje të re i datës 18.03.2010
- Me datë 06.04.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë regjistrimin e grupit matës nr. 70172339 si dhe kanë bërë pranimin e instalimit bazuar në pëlqimin elektroenergjetik.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 006408 i datës 06.04.2010
- Me datë 07.05.2010 bazuar në pëlqimin elektroenergjetik punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se matja e energjisë elektrike bëhet përmes njehsorit gjysmë indirekt si dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse. Punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë evidentuar se konsumatori ka bërë ndërrimin e transformatorëve rrymor nga 150/5A në 100/5 A.



**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 378202 i datës 07.05.2010

- Me datë 12.07.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se matja e energjisë elektrike bëhet sipas pëlqimit elektroenergjetik. Ekipi i KEK-ut konstaton se konsumatorit tani e tutje duhet t'i bëhet përmirësimi i faturimit me konstant nga C=30 në C=20 bazuar në procesverbalin e pranimit teknik të grupi matës. Punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë evidentuar se konsumatori nuk prezanton njehsorin e vjetër elektrik nr. 70172808.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 378223 i datës 12.07.2010

- Me datë 12.08.2010 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me rikthim të humbjeve fatura DPR10HP08574 në vlerë prej 4969.60 €.

**Provë:** Fatura DPR10HP08574 e datës 12.08.2010

- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 01.03.2011 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e nr. 378223 të datës 12.07.2010.

**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 01.03.2011

- Me datë 28.03.2011 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, dhe vërejtur se:

- ✓ KEK-u me datë 10.09.2009 i ka lëshuar konsumatorit Shpk "Steda Kosova" (ish Hotel Unionit), Pëlqimin elektronenergjetik të përkohshëm me fuqi instaluese prej 50 kVA, ku matja e energjisë elektrike duhet të bëhet me njehsor shumë-funksional (aktive, reaktive dhe maksigraf) dhe i lidhur përmes TMRR 75(100)/5 A/A.

**Provë:** Pëlqimi elektronenergjetik i përkohshëm i KEK-ut nr. 4674 i datës 10.09.2009

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 03.11.2009 bazuar në pëlqimin elektroenergjetik të lëshuar nga KEK-u me datë 10.09.2009 kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik me nr. 70172808 është shumë-funksional. Punëtorët e KEK-u gjatë inspektimit përveç tjerash kanë konstatuar se që energjia aktive regjistrohet në tri tarifa dhe si i tillë nuk mund të pranohet nga KEK-u. Punëtorët e KEK-ut kanë udhëzuar konsumatorin që në afat 3-5 ditë të bëjnë ndërrimin e njehsorit elektrik në njehsor shumë-funksional e të licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës si dhe duhet të përmbahet pëlqimit elektroenergjetik duke ndërruar TMRR nga 150/5A në 75/5A. Ekipi i KEK-ut po ashtu ka regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse duke përfshi gjendjen e njehsorit. Punëtorët e KEK-u gjatë këtij inspektimi nuk kanë marrë me vete njehsorët elektrik, por vetëm kanë udhëzuar se këta njehsor elektrik nuk mund të regjistrohen nga ana e KEK-ut

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 183264 i KEK-ut i datës 03.11.2009

- ✓ Pas kërkesës së konsumatorit për regjistrimin e njehsorit elektrik punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 06.04.2010 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë pranimin e pikës matëse duke u bazuar në pëlqimin elektroenergjetik. Njehsori elektrik aktiv i cili është regjistruar nga KEK-u është njehsori nr. 70172339 si dhe duhet theksuar se me këtë rast punëtorët e KEK-ut kanë evidentuar edhe gjendjen e shpenzimit në atë njehsor elektrik.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 006408 i KEK-ut i datës 06.04.2010



- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut duke u bazuar në pëlqimin elektroenergjetik të KEK-ut me datë 07.05.2010 prapë kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se matja e energjisë elektrike bëhet përmes njehsorit gjysmë indirekt si dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse. Punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë evidentuar se konsumatori ka bërë ndërrimin e transformatorëve rrymor nga 150/5A në 100/5 A.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 378202 i datës 07.05.2010
- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 12.07.2010 kanë bërë prapë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se matja e energjisë elektrike bëhet sipas pëlqimit elektroenergjetik. Punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë konstatuar se duke u bazuar në procesverbalin nr. 006408 të datës 06.04.2010 konsumatori më herët është faturuar me konstante C=30 ndërsa tani e tutje konsumatori duhet të faturohet me konstante C=20. Punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë evidentuar se konsumatori nuk prezanton njehsorin e vjetër elektrik nr. 70172808. Duhet theksuar se KEK-u ka qenë në dijeni se konsumatori edhe më herët në procesverbalet tjera nuk posedon njehsorin e vjetër dhe se që nga procesverbali i parë kur edhe ka konstatuar se nuk pranon njehsorin e vjetër është dashur të merr njehsorin me vete atë njehsor e jo të kërkoj nga konsumatori njehsorin mbas nëntë (9) muajve.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 378223 i datës 12.07.2010
- ✓ Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe transaksioneve të konsumatorit konstatohet se regjistrimi i konsumatorit në programin e KEK-ut si dhe regjistrimi i shpenzimit të energjisë është në kundërshtim me protokollin e pranimit teknik të njehsorit elektrik. Zyrtarisht KEK sha ka pranuar instalimin e njehsorit nr. 70172339 me datë 06.04.2010 si dhe ka regjistruar shpenzimet e regjistruar në atë njehsor, por të dhënat e njehsorit elektrik të konsumatorit janë regjistruar në programin e KEK-ut vetëm në periudhën 07/2010.  
**Provë:** Rrjedha e energjisë elektrik dhe transaksionet e konsumatorit
- ✓ Bazuar në procesverbalet e përpiluara nga punëtorët e KEK-ut (procesverbalet nr. 378202 i datës 07.05.2010 dhe nr. 378223 i datës 12.07.2010), vërehet se edhe përkundër mos prezantimit të njehsorit të vjetër nga konsumatori, punëtorët e KEK-ut nuk i kanë evidentuar pajisjet të cilat posedon konsumatori në objekt si dhe nuk kanë evidentuar se në çfarëdo mënyre kanë qenë të penguar nga konsumatori në kryerjen e detyrave të tyre.
- ✓ Me datë 12.08.2010 KEK-u duke u bazuar në kontrollin e bërë nga ekipet e autorizuar për inspektimin e pikave matëse ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë me anë të faturës DPR10HP08574 në vlerë prej 4,969.60 €. DMK gjatë analizës së bërë kalkulimit të faturës së rikthimit të humbjeve DPR10HP08574 të datës 12.08.2010 të përpiluar nga departamenti i faturimit në KEK, ka konstatuar se KEK-u ka gabuar në llogaritjen e faturës së rikthimit të humbjeve ngase nuk ka respektuar nenin 12 të procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar por që ka marruar për bazë fuqinë sipas PPE (pëlqimit elektroenergjetik) e që një kalkulim i tillë bëhet në rastet kur ekipeve të autorizuar të KEK-ut nuk iu lejohet qasje në objektin komercial për evidentimin e pajisjeve elektrike të instaluara.  
**Provë:** Fatura e rikthimit të humbjeve DPR10HP08574 të datës 12.08.2010
- ✓ Konsumatori ka ofruar procesverbalin e përpiluar nga punëtorët e Inspektoratit Komunal Ndërtimor në Prishtinë nr. 354 të datës 11.01.2010 me të cilin vërtetohet se punëtorët komunal kanë kërkuar nga Investitori të ndal rrënimin e pjesës së objektit për të cilën investitori nuk ka pëlqim.



**Provë:** Procesverbali për kontrollin inspektues nr. 354 i datës 11.01.2010

- ✓ KEK-u me datë 16.12.2010 kanë lëshuar urdhër lejimin / ngarkimin nr. 29774 për shifrën DPR – 90062031, ku ka zbritur vlerën prej 1355.58 €, në arsyetimin se korrigjimi i faturës 11/2010 është bazuar në listën e leximit 11/2010 dhe procesin e KEK-ut nr. 014364 të datës 29.11.2010.

**Provë:** Urdhër lejimi / ngarkimi nr. 29774 i datës 16.12.2010

- ✓ KEK-u me datë 04.08.2010 konsumatorit i ka dërguar faturën e energjisë elektrike në shifrën DPR – 90062031 në vlerë prej 541.99 €. Kjo faturë konsumatorit i ka arritur për njehsorin nr. 70172808, i cili sipas procesverbalit nr. 183264 të datës 03.11.2009 nuk është pranuar nga punëtorët e KEK-ut. Kjo faturë e arritur nga KEK-u është me gjendje të shpenzuar dhe evidentohet si e matur. Po ashtu kjo faturë konsumatorit i është llogaritur me konstante prej C=30.

**Provë:** Fatura e KEK-ut e muajit 07/2010

- ✓ KEK-u prapë me datë 04.08.2010 konsumatorit i ka dërguar faturën e energjisë elektrike në shifrën DPR – 90062031 në vlerë financiare prej 366.01 €. Kjo faturë konsumatorit i ka arritur për njehsorin nr. 70172339, i cili njehsori është regjistruar me datë 06.04.2010 (procesverbali nr. 006408). Sipas këtij procesverbalit të KEK-ut njehsori nr. 70172339 ka pasur gjendje të shpenzuar dhe si të tillë edhe e ka regjistruar. Nga kjo vërehet se konsumatori këtë njehsor e ka montuar edhe pas kësaj periudhe. Përveç tjerash vlen të theksohet se ky njehsor është regjistruar me datë 06.04.2010 ndërsa është faturuar tek mbas tre muajve. Kjo faturë e arritur nga KEK-u është me gjendje të shpenzuar dhe evidentohet si e matur. Po ashtu kjo faturë konsumatorit i është llogaritur me konstante prej C=20.

**Provë:** Fatura e KEK-ut e muajit 07/2010

- ✓ Gjatë analizave të bëra dy faturave të ngarkuara nga KEK me datë 04.08.2010 për muajin 07/2010 për njehsor të ndryshëm vërehet se shpenzimi i regjistruar në këto dy fatura është i njëjtë. Sipas analizave të bëra faturave të energjisë elektrike të dy faturave për të njëjtën periudhë dhe për të njëjtën shifër por me njehsor të ndryshëm vërehet qartë se shpenzimi i energjisë elektrike është pothuajse i njëjtë, dhe se dallimi i vetëm është se për njërin faturë është përdorur dy konstante: njëra me konstante C=30 dhe tjetra me konstante C= 20. Po ashtu duhet theksuar se për periudhën për të cilën KEK-u po e ngarkon konsumatorin me dy fatura ka ekzistuar njehsori nr. 70172339 e jo njehsori i vjetër të nr. 7017808 të cilën nuk e ka pranuar as vet KEK-u. Andaj sipas kësaj duhet theksuar se KEK-u ka gabuar kur e ka faturuar konsumatorin me dy fatura, pasi që njehsori i vjetër nuk është pranuar fillimisht nga KEK-u dhe se punëtorët e KEK-ut disa herë para kësaj fature kanë dalur te konsumatori dhe e kanë inspektuar pikën matëse.

**Provë:** Faturat e muajit 07/2010

- ✓ Sipas transaksioneve të konsumatorit me shifër DPR – 90062031 Steda Kosova (ish Hotel Unioni) vërehet se KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me dy fatura për muajin 07/2010, ku njëra faturë e muajit 07/2010 është në vlerë prej 366.01 €, ndërsa tjetra është në vlerë prej 541.99€. Këto fatura për muajin 07/2010 i kanë arritur konsumatorit me datë 04.08.2010. Para këtyre dy faturave konsumatorit i ka arritur një ngarkesë për rikthim të humbjeve në vlerë prej 4969.60 €. Pas këtyre dy faturave të muajit 07/2010 konsumatorit i kanë arritur fatura të ulëta në vlera të ndryshme prej 10.53 €, 14.23 € dhe 20.49 €. Pas këtyre faturave të ulëta KEK-u nëpërmjet urdhër lejimit / ngarkimit nr. 29774 me datë 16.12.2010 nga borxhi i përgjithshëm ka zbritur një vlerë 1355.58 €, ndërsa në faturën e muajit 11/2010 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore prej 1368.43 €.

**Provë:** Transaksionet e konsumatorit e shifrës DPR – 90062031



- ✓ Konsumatori në ankesën e tij thekson se me datë 10.09.2009 ka pranuar nga KEK-u pëlqimin elektroenergjetik. Pas dhënies së pëlqimit elektroenergjetik nga KEK-u konsumatori thekson se ka angazhuar kompaninë “Elektro Mont” nga Ferizaj për kryerjen e punëve elektrike, e cila kompani sipas konsumatorit edhe ka bërë vendosjen e njehsorit elektrik. Konsumatori po ashtu ka theksuar se punëtorët e KEK-ut kanë ardhur në kontroll me datë 09.11.2009 dhe kanë kërkuar nga ne që të largojmë nga matja njehsorin elektrik nr. 70172808 dhe se brenda afatit 3-5 ditëve duhet të vendoset njehsori tjetër. Konsumatori thekson se sipas udhëzimeve të KEK-ut ka vepruar ashtu që brenda 24 orëve ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik por që nuk ka qenë i njoftuar që ora e vjetër duhet të dorëzohet në KEK. Njehsori i vjetër sipas konsumatorit është larguar nga matja është kthyer në Turqi. Konsumatori po ashtu thekson se punimet në punishte nuk kanë zgjatur shumë pasi që Komuna e Prishtinës ka ndërprerë punimet e mëtutjeshme.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit e konsumatorit

- ✓ Sipas analizave të bëra dokumenteve të prezantuara vërehet se KEK-u me datë 10.09.2009 i ka lëshuar konsumatorit pëlqimin elektroenergjetik të përkohshëm. Pas kësaj konsumatori ka montuar një njehsor elektrik i cili me datë 03.11.2009 nuk është pranuar nga punëtorët e KEK-ut dhe është kërkuar të bëjë ndërrimin e njehsorit elektrik. Me këtë rast KEK-u vetëm i ka kërkuar konsumatorit të bëjë ndërrimin e njehsorit pasi ai njehsori është me tre tarifa dhe se si i tillë nuk pranohet, si dhe ka kërkuar të bëjë ndërrimin e transformatorëve matës rrymor. KEK-u nuk e ka marrë njehsorin me vete me rastin e kontrollimit por as nuk i ka kërkuar konsumatorit që atë njehsor të dërgon në KEK. Pas kësaj konsumatori ka parashtruar kërkesë për lidhje të re dhe se me datë 06.04.2010 KEK-u ka dalur te konsumatori dhe ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 70172339 me gjendje të shpenzuar. Edhe pas kësaj konsumatori ka pasur inspektime tjera nga ana e KEK-ut si ajo e datës 07.05.2010 (procesverbali nr. 378202) në të cilin procesverbal përveç tjerash theksohet se konsumatori ma herët ka pasur një njehsor tjetër me gjendje të evidentuar dhe se tani nuk prezanton njehsorin e vjetër. Sipas kësaj duhet theksuar se KEK-u ka qenë në dijeni për atë njehsor dhe i ka kërkuar vet konsumatorit që ta ndërroj dhe se nga ajo periudhë KEK nuk ka dalur ta ndërroj dhe ta merr me vete për inspektim. Edhe pas këtij procesverbali, punëtorët e KEK-ut prapë kanë dalur për inspektim me datë 12.07.2010 dhe se ka konstatuar se tani matja bëhet sipas pëlqimit elektronenergjetik dhe se deri në procesverbalin nr. 006408 të faturohet konsumatori me konstante  $C=30$  dhe se prej kësaj periudhe të faturohet me konstante prej  $C=20$ . Pas kësaj KEK-u me datë 12.08.2010 e ka ngarkuar konsumatorin me rikthim të humbjeve sipas pëlqimit elektroenergjetik. KEK-u duhet theksuar se ka qenë te konsumatori disa herë për inspektim dhe se ka pasur vazhdimisht qasje te objekti i konsumatorit dhe se asnjëherë nuk i ka marr për të regjistruar pajisjet elektrike në atë objekt. KEK-u sipas faturave dhe transaksioneve të konsumatorit ka faturuar konsumatorin me dy fatura për të dy njehsorët me grumbullim të shpenzimit dhe se nuk është dashur ta ngarkoj me rikthim të humbjeve vetëm në arsyetimin e mos prezantimit të njehsorit elektrik kur edhe vet nuk e ka pranuar për ta regjistruar.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR10HP08574 të datës 12.08.2010 në vlerë 4,969.60 €.
2. Të shkarkojë konsumatorin nga fatura e energjisë elektrike nr. 071088610DPR-90062031 e datës 04.08.2010 në vlerë prej 541.99 €



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Enver Halimi, anëtar